

atrc.

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA

Përkrah
komunitetin e OJQ-ve



AVOKUESI

Vëllimi IV • Numri 4 • Maj 2006

PËRMBAJTJA

Faqe 2

“Shoqëria civile duhet të ofroj zgjidhje, jo vetëm të jetë kritike ndaj faktorëve politik”

Institucionet qeverisëse dhe sektori i OJQ-ve të inicojnë formë të re komunikimi

Fushata “Unë Vendos për Veten Time” kundër trafikimit të njerëzve

Faqe 3

Sekretet e rrjetit të suksesshëm janë anëtarët e tij, thotë Rrjeti i Grave të Kosovës

OJQ nga Kosova dhe Serbia bashkëpunuan për të monitoruar mediat e shkruara

Elbasan Hoti është zgjedhur kryetar i Parlamentit Studentor

Faqe 4

Iniciativa qytetare e grave “Antico” po mbledh fonde për viktimat e dhunës familjare në Maqedoni

Ndërtimi i kredibilitetit u mundëson OJQ-ve të jenë të besueshme

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: www.advocacy-center.org

OJQ-të të krijojnë ambient të brendshëm rregullativ për luftim efikas të korrupsionit

Shoqëria civile mund të luaj rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit në sektorin publik, mirëpo që të jetë efektive, duhet të krijoj besueshmëri publike, duke luftuar korrupsionin brenda vetvetes.

Çështja e korrupsionit në shoqërinë civile është diskutuar nga përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave vendore gjatë një debati publik më 3 prill, të organizuar nga ATRC-ja dhe “Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet - Çohu”.

Panelistët e këtij diskutimi ishin Barbara Hall - IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile, Berat Buzhala - gazeta Express dhe Bashkim Rrahmani - Fondacioni për Iniciativa Demokratike. Gjatë prezantimeve të tyre, panelistët u përqendruan në atë se çfarë duhet të bëjnë OJQ-të që të jenë transparente, kush duhet ta luftoj korrupsionin në shoqërinë civile, perceptimi publik për korrupsionin në

shoqërinë civile, si dhe roli i donatorëve në ngritjen e transparencës së shoqërisë civile.

Panelistët, sikurse edhe pjesëmarrësit e tjerë, përmenden rastet e korrupsionit në shoqërinë civile po e dëmtojnë besueshmërinë dhe ligjshmërinë e saj, gjë që mund të rezultojë me humbje të besimit publik.

Kodi i Etikës për OJQ-të
Alban Bokshi nga Çohu paraqiti një draft tekst për kodin e etikës për OJQ-të, duke veçuar se ai do të përmirësonte perceptimin publik ndaj OJQ-ve. “Një kod i etikës për OJQ-të do të përmirësonte imazhin e tyre dhe do të ishte shembull para qytetarëve dhe qeverisë për një qeverisje të mirë dhe



Pjesëmarrësit në debatin për çështjen e korrupsionit në shoqërinë civile

transparente - për një shoqëri civile të lirë dhe demokratike”, ka deklaruar ai.

Debati përfundoi me zgjedhjen e një grupi përfaqësuesish të OJQ-ve (Çohu, ATRC, Avonet, Riinvest, Rrjeti i Grave të Kosovës, Rrjeti Rinor, dhe Forumi i OJQ-ve të Gjakovës), i cili është përgjegjës për informim dhe koordinim të OJQ-ve në mbarë Kosovën për të përpiluar një kod final dhe të përbashkët të etikës.

Për më shumë informata lidhur me kodin e etikës për OJQ-të, ju lutem kontaktori: organizata-cohu@yahoo.com



Sesion trajnimi në ATRC më 20 prill

ATRC organizon sesione trajnimi për OJQ

ATRC-ja ka zhvilluar tri punëtori trajnimi gjatë muajit prill për menaxhim të OJQ-ve, shkrim të projekt propozimeve, ngritje të fondeve dhe marrëdhëniet me donatorë.

Këto trajnime janë pjesë e ciklit të punëtorive të këtij viti, të cilat u ofrohen të gjitha OJQ-ve kosovare të regjistruara si klientë të ATRC-së. OJQ-të të cilat nuk janë të regjistruara dhe janë të interesuara për shërbimet e ATRC-së (falas për OJQ-të kosovare), mund ta plotësojnë formularin e regjistrimit, i cili mund të merret në faqen e Internetit www.advocacy-center.org ose në zyret e ATRC-së: Rr. Agim Ramadani, Nr.15, Prishtinë.

Flash Lajme

Fushata “Unë Vendos për Vetën Time” kundër trafikimit të njerëzve

Organizata joqeveritare “INTEGRA” ka implementuar në muajin prill edicionin e dytë të fushatës së saj kundër trafikimit të qenieve njerëzore të titulluar “Unë vendos për vetën time”. Përmes shpërndarjes së materialeve të printuara informative dhe shfaqjes së filmit amerikan, “Largim - Jeta në Rrezik”, në vende të frekuentuara nga shumë njerëz, fushata synon të informoj dhe ngrit vetëdijen në mesin e qytetarëve për çështjet që kanë të bëjnë me trafikimin e njerëzve.

Ekipi i fushatës ka udhëtuar në dhjetë komuna të Kosovës, të përfshira në këtë fushatë (Gjakovë, Ferizaj, Lipjan, Gjilan, Skenderaj, Vushtri, Drenas, Klinë, Istog dhe Podujevë).

INTEGRA po e implementon këtë fushatë në kuadër të programit të saj kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të përkrahur nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Qeveria e Finlandës, dhe Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë.



Fushata “Unë Vendos për Vetën Time” është pjesë e një programi të INTEGRA-së kundër trafikimit të njerëzve

Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Zyret e Presidentit dhe Kryeministrit

“Shoqëria civile duhet të ofroj zgjidhje, jo vetëm të jetë kritike ndaj faktorëve politik”

ATRC-ja ka organizuar tryezë të rrumbullakët më 28 mars ndërmjet OJQ-ve vendore dhe këshilltarëve politikë për shoqëri civile të Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës, Samet Dalipi dhe Jahja Lluka, për të themeluar mekanizma të ri bashkëpunimi bazuar në nevojat e shoqërisë civile.

Përfaqësues të OJQ-ve dhe këshilltarët politik përpiluan disa rekomandime, me qëllim të krijimit të marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet qeverisë dhe sek-



Një sër rekomandimesh janë përpiluar për të shtuar bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë

torëve të shoqërisë civile. Rekomandimet e përpiluara gjatë këtij takimi janë:

- Shoqëria civile të angazhohet aktivisht në përpilimin e buxhetit të Kosovës
- Një pjesë e buxhetit të Kosovës të ndahet për OJQ-të

- Shoqëria civile dhe institucionet qeverisëse të kenë takime të shpeshta, dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet qendrore qeverisëse të fokusohet në çështje avokuese
- Zyra e qeverisë për çështje gjinore të shndërrohet në agjenci

- Një kod i etikës të përpilohet dhe implementohet nga qeveria

- Të përshejtohet procesi i miratimit të ligjeve

- Të gjitha draft ligjet të publikohen në web faqet e qeverisë para se të miratohen nga parlamenti
- Të themelohet një kës-

hill kombëtar për personat me aftësi të kufizuara

- Të miratohet ligji për asistencë familjeve të personave me aftësi të kufizuara

Jahja Lluka, këshilltar i Kryeministrit, informoi OJQ-të se shefi i ekzekutivit, Agim Çeku, është i interesuar në formimin e një paneli të shoqërisë civile, të cilit drejtpërdrejt do t'i raportonte.

Veç kësaj, Lluka shtoi se, “në të ardhmen e afërt, Zyra e Kryeministrit do të paraqes një projekt lidhur me angazhimin e shoqërisë civile në procesin e implementimit të standardeve për Kosovën”.

Përfaqësues të OJQ-ve komentuan se shoqëria civile duhet të ofroj rekomandime specifike e jo vetëm të jetë kritike ndaj të gjithë faktorëve që operojnë në Kosovë.

Institucionet qeverisëse dhe sektori i OJQ-ve të inicojnë formë të re komunikimi

Përfaqësues të OJQ-ve lokale dhe Hashim Thaçi, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe anëtarë i Ekipit Negociator për statusin final politik të Kosovës, janë takuar më 22 mars në ATRC për të diskutuar sfidat e opozitës ndaj qeverisë dhe negociatave për status.

Takimi, i organizuar nga ATRC-ja, synon takimin e anëtarëve të ekipit negociator me përfaqësues të shoqërisë civile.

Procesin historik të zgjidhjes së çështjes së statusit final të Kosovës dhe ballafaqimin me qeverisje të dobët, HashimThaçi i identifi-

koi sfidat kryesore të partive opozitare në Kosovë.

Përfaqësuese të OJQ-ve të grave përmenden çështjen e përfshirjes së grave në ekipin negociator dhe kërkuar nga Thaçi të ndër-

merr hapa konkret ndaj kësaj çështje dhe të mos vazhdoj me premtime boshë, të dëgjua më parë.

“Statusi është çështje e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh a janë meshkuj apo femra”, pohoi Thaçi.

Shumica e pjesëmarrësve veçan se OJQ-të dhe institucionet qeverisëse duhet t'i kontribuojnë debatit të përgjithshëm të inicuar nga shoqëria civile për çështjet që shqetësojnë qytetarët e Kosovës, dhe po ashtu të inicojnë formë të re komunikimi ndërmjet këtyre dy sektorëve.



Hashim Thaçi informoi OJQ-të lokale për sfidat e opozitës

Flash Lajme

Elbasan Hoti është zgjedhur kryetar i Parlamentit Studentor

Studentë të Universitetit të Prishtinës formuan më 11 prill parlamentin e tyre dhe zgjedhën udhëheqësit, një muaj pas zgjedhjeve studentore të 8 marsit.

Elbasan Hoti, përfaqësues i "Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës" është zgjedhur kryetar, ndërsa dy nënkryetarët e zgjedhur janë Sejdi Hoxha (Unioni i Pavarur i Studentëve të Kosovës) dhe Gëzim Qerimi (Paqja Studentore).

Hoti është zotuar se gjatë mandatit të tij, parlamenti do të shërbej si mekanizëm mbrojtës i të drejtave të studentëve.

Shtatëmbëdhjetë anëtarë të gjashtë organizatave studentore (Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës, Unioni i Pavarur i Studentëve të Kosovës, Paqja Studentore, Lista Studentore - Reforma, Organizata e Re Studentore dhe Unioni i Shqiptarë i Studentëve) janë të përfaqësuar në këtë parlament.



Gjashtë organizata i përfaqësojnë studentët e Universitetit të Prishtinës në parlamentin e tyre

Ndërtimi i një rrjeti të suksesshëm

Sekreti i rrjetit të suksesshëm janë anëtarët e tij, thotë Rrjeti i Grave të Kosovës



Anëtarët e RrGK-së shqyrtojnë planin strategjik të rrjetit për vitin 2005 gjatë një takimi vjetor të anëtarësisë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), i cili avokon në emër të grave në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, aktualisht përbëhet nga 85 organizata anëtare të të gjitha etniteteve nga mbarë Kosova, gjë që e bën atë një ndër rrjetet më të mëdha funksionale në rajon.

Edhe pse i themeluar në vitin 2000, anëtarët e parë që nga mesi i viteve të 90-ta takoheshin jo zyrtarisht për të ofruar përkrahje mo-

rale, këmbim përvojash dhe zgjidhje të problemeve për çështje me interes të përbashkët.

Pas më shumë se një dekade, rrjeti ende funksionon në këtë mënyrë. "Anëtarët janë prioritet", ka sqaruar Igjalle Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGK-së. "Ne jemi për t'iu shërbyer anëtarëve tonë. Sa më shumë anëtarë aktivë të ketë një rrjet, aq më i fuqishëm është zëri i tij në vendimmarrje", ka thënë ajo.

RrGK i ka bërë anëtarët aktiv duke i telefonuar personalisht për t'i ftuar në takime; informuar përmes web faqes, postës elektronike, takimeve dymujore, raportit vjetor dhe buletinit tremujor; duke i përfshirë në planifikimin strategjik

dhe vlerësimin e punës së RrGK-së: dhe, duke i angazhuar rregullisht në aktivitete.

Në secilën fushatë avokuese të RrGK-së, anëtarët kanë luajtur rol kyç. Gjatë fushatës kundër dhunës ndaj femrave dhe fushatës "Njih të Drejtat Tuaja", anëtarët kanë organizuar aktivitete në komunat e tyre. Për fushatat "Gratë Propozojnë" dhe "Partitë Politike Punojnë për Gratë", anëtarët organizuan takime ndërmjet kandidateve elektorale dhe qytetarëve, ku këta të fundit ngrenë zërin për prioritetet e tyre. Anëtarët e RrGK-së po ashtu u bashkuan për të ndryshuar sistemin elektoral dhe përfshirjen e grave në bisedimet për statusin final politik të Kosovës.

Për më shumë informata, vizitoni: www.womensnetwork.org

Monitorimi i mediave

OJQ nga Kosova dhe Serbia bashkëpunuan për të monitoruar mediat e shkruara

Organizata joqeveritare "Iniciativa për Paqe" prezantoi më 4 prill në Hotelin Grand në Prishtinë, një raport monitorues të mediave të shkruara në Kosovë dhe Serbi, të monitoruara gjatë periudhës shtator - tetor 2005. OJQ-ja "Fractal" nga Beogradi ka monitoruar gazetën e përditshme në Serbi.


Monitorimi është përqendruar në shkrimet për statusin final të Kosovës, kthimin e personave të zhvendosur dhe raportin e të dërguarit të OKB-së, Kai Eide lidhur me implementimin e standardeve për Kosovën.

Gazmir Rraci nga "Iniciativa për Paqe" ka njoftuar se ky monitorim synon të paraqes pasqyrë reale të ndikimit të mediave të shkruara në kthimin e personave të zhvendosur dhe proceset ri-integruese në Kosovë.

Sipas raportit, tri nga katër të përditshmet kosovare kanë ndryshuar mënyrën e raportimit pas kritikave për "raportim agresiv, sugjestiv dhe provokues" gjatë trazirave të marsit të vitit 2004.

Gazetat e monitoruara në Kosovë dhe Serbi janë Koha Ditore, Zëri, Epoka e Re, Bota Sot, Danas, Poli-

tika, Veçernje Novosti dhe Kurir. Përgjedhja e këtyre të përditshmeve është bazuar në lexueshmërinë e tyre.



Tetë gazeta të Kosovës dhe Serbisë janë monitoruar nga OJQ-të "Iniciativa për Paqe" dhe "Fractal"



Drejtoreshë Ekzekutive
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org

Menaxher i Financave & Administratës
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

Menaxher i Shërbimeve të Trajnimeve & Konsulencave
ILIR HOXHA
ilir@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
MERITA BARILEVA
merita@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org

Bashkëpunëtoreshë e Programit
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

Menaxhere për Komunikim & Ndërlidhje
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org

Menaxher për IT dhe Databasë
ARMEND SUSURI
armend@advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

Një ide inovative për ti ndihmuar viktimat e dhunës në familje

Iniciativa qytetare e grave “Antico” po mbledh fonde për viktimat e dhunës familjare në Maqedoni

Iniciativa qytetare e grave maqedonase “Antico” njoftoi më 12 prill fillimin e një fushate për t’iu siguruar ndihmë financiare dhe materiale viktimave të dhunës familjare.

Artikujt e mbledhur do të shi-



Dhuna familjare është në rritje e sipër në Maqedoni, raportojnë OJQ-të lokale

ten këtë muaj në një ankand në Hotelin Kontinental në Shkup.

Fondet e mbledhura gjatë ankandit dhe donacionet synojnë të pajisin plotësisht “Qendrën HOPE për Viktima të Dhunës” në Maqedoni.

Sipas Makedonka Ivanova nga “Hope” numri i atyre që kanë kërkuar ndihmë dhe raportet për dhunë familjare janë në rritje e sipër.

Antico po e implementon këtë iniciativë në kuadër të projektit “Ngritja e Kapaciteteve të Organizatave Civile në Rrjetin Antico”.

Ligji ndaj dhunës familjare në Maqedoni është miratuar në vitin 2004, pas së cilit organizatat kanë ndërmarë hapa konkret për të parandaluar dhunën në familje dhe për t’iu siguruar asistencë të organizuar këtyre viktimave.

Aktualisht, Maqedonia po e përgatit një protokoll për koordinim të të gjitha OJQ-ve dhe institucioneve shtetërore, të cilat u ofrojnë asistencë viktimave të dhunës familjare.

Burimi: Një Botë / Evropa Juglindore

Faktorët që ndikojnë në besueshmërinë dhe legjitimitetin e një OJQ-je

Ndërtimi i kredibilitetit u mundëson OJQ-ve të jenë të besueshme

Kredibiliteti është një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në punën e OJQ-ve.

Të jesh kredibil është thjeshtë perceptimi i të qenurit i besueshëm. Një sërë strategjish mund të përdoren nga OJQ-të për të ndërtuar kredibilitetin e tyre:

- Angazhimi i akademikëve dhe ekspertëve për të vlerësuar projektet dhe aktivitetet e OJQ-së

- Bashkimi me shoqata, aleanca ose forume kombëtare ose rajonale

- Sigurimi i akreditimit të OKB-së

- Angazhimi i një zëdhënësi të besueshëm

- Paraqitje publike dhe publikime të rregullta

- Kërkim i shpërblimeve dhe çmimeve si mirënjohje për punën e kryer

- Partneritet me entitetet më

të rëndësishme të komunitetit, qeverisë dhe industrisë

- Shkrim të studimeve të cilat rrëfejnë tregime të njerëzve dhe komuniteteve të cilave u kanë shërbyer

- Sigurimi i shkrimeve të mirë në media

- Kuptim të fuqizimit të OJQ-së dhe lidhjeve me shtirje më të gjerë, njoftim të vazhdueshëm për fuqizim të OJQ-së dhe vendosje të lidhjeve të reja

- Prezencë domethënëse të



OJQ-të gjithnjë e më shumë po luajnë rol aktiv në arenat e sotme politike dhe sociale. Organizatat e shoqërisë civile po përhapen në mbarë botën. Nganjëherë, OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare sillen në mënyrë jo të përgjegjshme dhe dëmtojnë kredibilitetin e shoqërisë civile në përgjithësi. Organizatat duhet të japin llogari aq sa edhe qeveritë, që ato i kritikojnë. Kjo paraqet sfidë të madhe për zhvillimin e OJQ-ve dhe demokracinë globale në përgjithësi.

- Forumi i Politikës Globale

vazhdueshme në Internet - përmes web faqes dhe email-it

- Krijim të imazhit të mirë nëpërmjet publikimit të buletineve, komunikatave për media, etj.

Burimi: Qendra Hulumtuese për Zhvillim Global

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.